

VENDIM
Nr.3, datë 30.11.2019

PËR AKOMODIMIN E PËRKOHSHËM TË TË DËMTUARVE PËR SHKAK TË FATKEQËSISË NATYRORE NË QARQET DURRËS, TIRANË DHE LEZHË, NË STRUKTURAT AKOMODUESE

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, dhe të vendimit nr.750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile, i mbledhur sot, më 30.11.2019,

VENDOSI:

1. Banorët e banesave të dëmtuara për shkak të fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë të akomodohen përkohësisht në strukturat akomoduese, sipas listës paraprake të evidentuar nga Unioni Turistik Shqiptar (UTSH) dhe Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA), të dakordësuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Shpenzimet e akomodimit të përkohshëm mbulohen nga buxheti i shtetit, fondet e emergjencës, në vlerën 2 000 (dy mijë) lekë për person në ditë, bazuar në çmimin e negociuar, sipas raportit të grupit të punës të ngritur me urdhrin nr.384, datë 27.11.2019, të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe procedurës së ndjekur, ndërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Unionit Turistik Shqiptar (UTSH) dhe Shoqatës Shqiptare të Turizmit (ATA), sipas dokumentacionit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I KOMITETIT NDËRMINTOR
TË EMERGJENCAVE CIVILE**

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**LISTA PARAPRAKE E STRUKTURAVE AKOMODUESE TË EVIDENTUARA NGA
UTSH DHE ATA DHE TË DAKORDËSUAR NGA MTM**

Nr.	Emri hotelit	Vendndodhja e hotelit
1.	Hotel "Kolaveri"	Mali i Robit
2.	Hotel "Ibiza"	Golem
3.	Hotel "Fafa Premium"	Mali i Robit
4.	Hotel "Aleri"	Mali i Robit
5.	Hotel "Pishat e Buta"	Mali i Robit
6.	Hotel "Eter"	Mali i Robit
7.	Hotel "Kasa"	Mali i Robit
8.	Hotel "Vala"	Plazh i Madh Durrës
9.	Hotel "Diana Resort"	Golem
10.	Hotel "Bonita"	Golem
11.	Hotel "AS"	Golem
12.	Hotel "Ermiri"	Shëngjin
13.	Hotel "Rafaelo"	Shëngjin
14.	Hotel "Frojdi"	Shëngjin
15.	Hotel "Prestige"	Golem
16.	Hotel "Germany"	Plazh i Madh Durrës
17.	Hotel "Aragosta"	Plazh i Madh Durrës
18.	Hotel "Klajdi"	Mali i Robit
19.	Hotel "Dolce Vita"	Golem